

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kishin fshehur në autobus mallra të kontrabanduara nga Greqia dhe mbi 22 mijë euro/ Arrestohen 2 persona në Gjirokastrë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/kishin-fshehur-ne-autobus-mallra-te-kontrabanduara-nga-greqia-dhe-mbi-22-i587207
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 08:29:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 08:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e7076df03394813b729748325a696bdfd853414e4191ddf144b0ed869d553b0d
TEKSTI	6afe8a8bbe533d9198a574319a1f72ba88f34296ece03fc57b8e3bea816951b2
PAMJA	7acb7a99f720d82da7e36a9f12b82116606a94659a361a6d220b1abcec850ac5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	305281f93a9b57dacd2fc948678e1a11a46347d2873841774f34119441f6b94d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/305281f93a9b57dacd2fc948678e1a11a46347d2873841774f34119441f6b94d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie Zgjedhjet ne Rusi nen suime kibernetike, Moskë pretendon se sistemet e votimit u vune ne shenjester i e shtena me arme ne qender te Sarandes, vritet nje person (EMRI fundit

Kishin fshehur në autobus mallra të kontrabanduara nga Greqia dhe mbi 22 mijë euro/ Arrestohen 2 persona në Gjirokastrë



20 Shtator 2026, 10:40Kronika TEMA



Policia e Gjirokastrës ka finalizuar operacionin e koduar "Akciza 3", në kuadër të goditjes së rasteve të kontrabandës së mallrave.

Në pranga janë vënë dy persona, të dy banues në Tiranë. Sipas Policisë, ata u kapën në flagrancë teksa transportonin me autobus mallra të dyshuara të kontrabanduara nga Greqia.

Operacioni u zhvillua nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare, pas informacioneve të siguruar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore Rajonale Vlorë-Gjirokastrë.

Gjatë kontrollit të autobusit, në vende të mbyllura dhe të fshehura, shërbimet e Policisë gjetën 100 steka me cigare dhe 22 695 euro. Ndërkohë, në bagazhin e autobusit u konstatuan kuti me produkte të ndryshme deti dhe mishi, produkte bulmeti, kuti me medikamente, si dhe 13 thasë me veshje të markave të ndryshme.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan mallrat, autobusi dhe një aparat celular.

Dy të arrestuarit akuzohen për veprat penale "Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara", "Kontrabanda me mallra për të cilat paguhet akcizë", "Kontrabanda me mallra të tjera", "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë", "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë", "Fshehja e të ardhurave" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale".



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Të shtëna me armë në qendër të Sarandës, vritet një person \(EMRI\)](#)

10:16 Kronika

IKMT prish 5 objekte në Borsh

21:15 Kronika / 2 komente

[Takimi i përfaqësuesve të FBI me elitën e sigurisë në Tiranë, nga krimi i organizuar te dronët dhe paratë e krimit](#)

20:25 Kronika / 4 komente

[Akuzohen për falsifikim të dokumenteve dhe përfitim të padrejtë të pronave, dy ish-drejtorët e Kadastrës Fier mbeten në burg, një tjetër kalon në arrest shtëpie!](#)

20:15 Kronika



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.